SHTOJCA 1

Formulari i kërkesës për leje mjedisore


Emri i kompanisë	**“ ENISI“ SH.P.K**
Lloji i veprimtarisë	**Përpunim, thërrmim dhe seperim i shkëmbinjve gëlqeror Rritja e Kapaciteteve të prodhimit, Linja 1 dhe 2**
Vendi/Lokacioni ku zhvillon Veprimtarinë	**Z.K. Studençan, Suharekë**
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	**Ramadan Jashari**
Adresa	**Z.K. Studençan, Suharekë**
Telefoni, fax, e-mail	**+38344262433, enisishpk@outlook.com**
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	**Ramadan Jashari**
Adresa	**Z.K. Studençan, Suharekë**
Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	**. Certifikata e regjistrimit te Biznesit me nr. Unik Identifikues: 810633108, 23/08/2006** **. Formulari i plotësuar sipas kushteve ne shtojcën 2,** **. Pëlqimi Mjedisor për Linjen 1 dhe Linjen 2** **. Licenca KPMM-së: 2357/ KPMM/2025**
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit(euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë	**Kosto investive: 490,500.0 €**
Fatura e pagesës së tarifës për Lejes Mjedisore	**Po**
Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në Një (1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD)	**Po**



Shtojca 2


Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	"ENISI" SH.P.K Përpunim, thërrmim dhe seperim i shkëmbinjve gëlqeror Rritja e Kapaciteteve të prodhimit, Linja 1 dhe 2
	Vendi	Z.K. Studençan, Suharekë
	Adresa	Z.K. Studençan, Suharekë
	Nr. i tel./fax	+38344262433
	E-mail	enisishpk@outlook.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810633108, 23/08/2006
1.1.3.	Personi Përgjegjës i kompanisë	Ramadan Jashari
	Nr. i tel./fax	+38344262433
	E-mail	enisishpk@outlook.com
1.2. Të dhënat për kompaninë		
1.2.1.	Emri i kompanisë	"ENISI" SH.P.K Përpunim, thërrmim dhe seperim i shkëmbinjve gëlqeror Rritja e Kapaciteteve të prodhimit, Linja 1 dhe 2
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Z.K. Studençan, Suharekë

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Veprimtaria e kompanisë "Enisi" Sh.p.k. zhvillohet në Zonën Kadastrale Studençan, Komuna e Suharekës, në ngastrën P-72116045-00984-2. Në këtë lokacion kryhet përpunimi, thërrmimi dhe separimi i shkëmbinjve gëlqerorë, ndërsa projekti parasheh rritjen e kapaciteteve prodhuese përmes Linjës 1 dhe 2. Lokacioni ndodhet rreth 6.4 km larg nga qendra e Suharekës, me kohë udhëtimi afërsisht 11 minuta.  
2.2.	Numri kadastral i parcelës	Veprimtaria e kompanisë "Enisi" Sh.p.k. zhvillohet në parcelën kadastrale me numër P-72116045-00984-2, e cila ndodhet në Zonën Kadastrale Studençan, Komuna e Suharekës. Brenda kësaj parcele realizohet përpunimi, thërrmimi dhe separimi i shkëmbinjve gëlqerorë.


		
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Në afërsi ku është ndërtuar impianti i përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të shkëmbinjve gëlqeror nuk ka shtëpi banimi afër impiantit, distanca me e afërt me shtëpi banimi është mbi 313.50 m. 
2.4.	Të dhënat lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Lokacioni karakterizohet kryesisht nga vegjetacion i ulët, shkurre dhe sipërfaqe të pjesërisht të zhveshura si rezultat i aktiviteteve minerare dhe industriale. Në zonën përreth mund të hasen lloje të zakonshme të florës lokale, ndërsa fauna përfaqësohet kryesisht nga shpendë, insekte dhe gjitarë të vegjël. Brenda hapësirës ku zhvillohet veprimtaria nuk janë evidentuar habitate të veçanta, lloje të rralla ose zona të mbrojtura. Me zbatimin e masave për

		kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe menaxhimin e mbeturinave, ndikimi në florën dhe faunën përreth vlerësohet i kufizuar.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura	Sa i përket zonave te mbrojtura te cilat janë te prezantuara ne Planin zhvillimor komunal 2021-2029 në afërsi te lokacionit te projektit nuk ka zona te mbrojtura apo monumente natyrore te cilat mund te pengohen nga projekti. Siç po shihet edhe ne hartën topografike ne afërsi te lokacionit ku edhe është planifikuar instalimi i linjës se dyte te përpunimit, thërrmimit dhe separimit te shkëmbinjve gëlqeror nuk ka ndikim ne zonat e mbrojtura e as ne afërsi te këtij projekti nuk ka ndonjë zone te mbrojtur me ligj. Ne fshatin e Studençanit ka disa Xhami, kishe dhe Përmendore Kolektive të riparuara, dhe janë te lokalitetit të pasur arkeologjik, antikitet, stella, bazament, figura bronzi, varreza, përmendore kolektive. 


3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË


3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	Skema Teknologjike Linja 1




Skema Teknologjike Linja 2





ELEMENTET PERBERSE TE SEPERACIONIT

Nr.		Fuqia	Nr.		Fuqia
1	Bunkeri	---	16	Shirit transportues B=1200[mm]	7,5kW
2	Dozatori B=1600[mm]	18 kW	17	Mullar 2	180 kW
3	Vibratori B=1000[mm]	16 kW	18	Shirit transportues B=1200[mm]	16,5 kW
4	Thyst primar	130 kW	19	Hinka	-
5	Shirit transportues B=1000[mm]	7,5 kW	20	Shirit transportues B=1000[mm]	7,5 kW
6	Shirit transportues B=800[mm]	7,5 kW	21	Klasifikatori 3	50 kW
7	Klasifikatori 4	7,5 kW	22	Shirit transportues B=1000[mm]	7,5 kW
8	Shirit transportues B=800[mm]	7,5 kW	23	Mullar 3	180 kW
9	Shirit transportues B=1200[mm]	16,5 kW	24	Shirit transportues B=1000[mm]	7,5 kW
10	Klasifikatori 1	7,5 kW	25	Shirit transportues B=700[mm]	7,5 kW
11	Shirit transportues B=1200[mm]	16,5kW	26	Shirit transportues B=700[mm]	7,5 kW
12	Mullar 1	180 kW	27	Shirit transportues B=700[mm]	7,5 kW
13	Shirit transportues B=1200[mm]	16,5kW	28	Shirit transportues B=700[mm]	7,5 kW
14	Klasifikatori 2	7,5kW	29	Shirit transportues B=700[mm]	7,5 kW
15	Shirit transportues B=1200[mm]	16,5kW	30	Shirit transportues B=700[mm]	7,5 kW
					P=849 kW



3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Procesi teknologjik i impiantit zhvillohet përmes dy linjave të veçanta, Linjës 1 dhe Linjës 2, të cilat përdoren për pranimin, thërrmimin, separimin dhe klasifikimin granulometrik të shkëmbinjve gëlqerorë. Të dyja linjat funksionojnë brenda të njëjtit lokacion dhe lidhen me sistemet përkatëse të furnizimit, transportimit dhe deponimit të fraksioneve të prodhuara. **LINJA 1** Linja 1 përbëhet nga hinka pranuese, sistemi i dozimit, thërrmuesit, sitat vibruese dhe shiritat transportues. Materiali gëlqeror pranohet dhe dërgohet në fazat e thërrmimit dhe separimit, ndërsa fraksionet e përfituara transportohen dhe deponohen në hapësirat e përcaktuara sipas granulometrisë.  **LINJA 2** Linja 2 paraqet kapacitetin shtesë të impiantit dhe përfshin pajisjet për pranimin, thërrmimin, separimin dhe transportimin e materialit. Funksionimi i saj është i koordinuar me Linjën 1, duke mundësuar rritjen

		e kapacitetit të përgjithshëm të prodhimit dhe ndarjen e materialit në fraksionet e kërkuara. 
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 ore x 5 dit 40 ore në javë orari punës prej orës 08:00 deri 16:00.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Impianti i përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të shkëmbinjve gëlqeror – rritja e kapacitetit të prodhimit Linja 1 dhe 2 ka një kapacitet të projektuar 2*200 = 400 m^3/h, të planifikuara ditor 2*1400m^3, të planifikuara mujore 2*35,000= 70,000.0 m^3, dhe të planifikuara vjetore 2*420,000 = 840,000.0 m^3/vit.
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse	Lënda e parë: - Shkëmbinjtë gëlqeror Lëndët ndihmëse: - Uji, - Energjia Elektrike
3.1.6.	Lista e rezervuarve edhe kapaciteti i tyre	Në kuadër të impiantit të kompanisë "Enisi" Sh.p.k., i vendosur në Zonën Kadastrale Studençan, Komuna e Suharekës, që merret me përpunimin, thërrmimin dhe separimin e shkëmbinjve gëlqerorë nuk ka rezervuar.
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve në Fuqi: Për plotësimin e formularit për Leje Mjedisore për kompaninë "Enisi" Sh.p.k. që merret me përpunimin, thërrmimin dhe separimin e shkëmbinjve gëlqerorë janë shfrytëzuar:

		→ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 → Ligjin nr. 04/L-060 për mbeturina, → Ligjin nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina → Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 05/L-025 → Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 → Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 → Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 → Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102 → Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110. → Udhëzimet Administrative: → Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes; → Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet , mënyrat ,parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit te ujerave te ndotura ne rrjetin e kanalizimit publik dhe trupin ujor.
3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit		
3.2.1	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania "Enisi" Sh.p.k., e cila ushtron veprimtarinë e përpunimit, thërrmimit dhe separimit të shkëmbinjve gëlqerorë në Zonën Kadastrale Studençan, Komuna e Suharekës, zbaton sistemin e organizuar për menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2. Sistemi menaxhues përfshin identifikimin dhe kontrollin e ndikimeve në ajër, ujë, tokë dhe zhurmë, zbatimin e masave për zvogëlimin e pluhurit, mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve dhe makinerive, menaxhimin e mbeturinave dhe parandalimin e rrjedhjeve aksidentale të vajrave apo karburanteve. Kompania ka caktuar personin përgjegjës për çështjet mjedisore, mbikëqyrë zbatimin e masave mbrojtëse, evidentimin e të dhënave dhe raportimin pranë institucioneve kompetente. Punëtorët trajnohen për përdorimin e sigurt të pajisjeve, reagimin

		në raste emergjente dhe respektimin e procedurave për mbrojtjen e mjedisit.
3.2.2	Raportimi	Kompania "Enisi" Sh.p.k. mbanë evidencë për zbatimin e masave mjedisore, menaxhimin e mbeturinave, kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe gjendjen e pajisjeve. Raportet përkatëse përgatiten dhe u dorëzohen institucioneve kompetente sipas kërkesave ligjore dhe kushteve të lejes mjedisore.

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve ematerieve ndotëse	Gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2 të kompanisë "Enisi" Sh.p.k., në Zonën Kadastrale Studençan, Komuna e Suharekës, emisionet në ajër lidhen kryesisht me krijimin e pluhurit gjatë përpunimit, thërrmimit, separimit, transportimit dhe manipulimit me shkëmbinjtë gëlqerorë. Pikat kryesore të burimit të emisioneve janë: shkarkimi i materialit në hinkën pranuese; ndarja e materialit steril dhe sitja vibruese; thërrmimi primar, sekondar dhe terciar; pikat e kalimit dhe shkarkimit të materialit nga shiritat transportues; deponimi dhe ngarkimi i fraksioneve përfundimtare; lëvizja e kamionëve dhe makinerive në rrugët e brendshme dhe sipërfaqet e thata. Gjatë këtyre proceseve mund të krijohen grimca pluhuri, kryesisht PM_{10} dhe $PM_{2.5}$. Emisione të kufizuara të gazrave mund të krijohen edhe nga motorët e kamionëve dhe makinerive të punës. Ndikimi është kryesisht lokal dhe kontrollohet përmes lagies me ujë të materialit, rrugëve dhe sipërfaqeve manipuluese, si dhe përmes mirëmbajtjes së rregullt të pajisjeve
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2, ndikimi në cilësinë e ajrit lidhet kryesisht me pluhurin që krijohet gjatë shkarkimit, thërrmimit, sitjes, transportimit dhe deponimit të shkëmbinjve gëlqerorë. Në ajër mund të lirohen grimca PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, ndërsa

		kamionët dhe makineritë e punës mund të emetojnë sasi të kufizuara të CO_2, CO, NO_x dhe SO_2. Ndikimi pritet të jetë lokal dhe i kufizuar, pasi procesi zhvillohet në ambient të hapur dhe do të zbatohen masa si lagia me ujë e materialit dhe rrugëve të brendshme, kufizimi i shpejtësisë së automjeteve dhe mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve në impiantin e kompanisë "Enisi" Sh.p.k. paraqiten kryesisht gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të materialit, thërrmimit, sitjes, transportimit me shirita, deponimit të fraksioneve dhe lëvizjes së kamionëve në rrugët e brendshme. Këto burime gjenerojnë kryesisht pluhur mineral, sidomos gjatë periudhave të thata dhe me erë. Ndikimi është lokal dhe zvogëlohet përmes lagies së materialit dhe sipërfaqeve manipuluese, pastrimit të rrugëve dhe mirëmbajtjes së rregullt të pajisjeve.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Në impiantin e kompanisë "Enisi" Sh.p.k. nuk parashihen pajisje të veçanta për trajtimin e gazrave shkarkuese, pasi procesi teknologjik zhvillohet kryesisht me pajisje elektrike dhe nuk përfshin procese të djegies. Gazrat shkarkuese krijohen vetëm nga kamionët dhe makineritë e punës, të cilat mirëmbahen rregullisht dhe do të plotësojnë standardet përkatëse të emetimeve.
4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Në impiantin e kompanisë "Enisi" Sh.p.k. përdoret sistemi i spërkatjes me ujë për zvogëlimin e pluhurit gjatë shkarkimit, thërrmimit, sitjes dhe transportimit të shkëmbinjve gëlqerorë. Spërkatja zbatohet edhe në rrugët e brendshme dhe sipërfaqet manipuluese, sidomos gjatë periudhave të thata.
4.6.	Monitorimi iemisioneve	Kompania "Enisi" Sh.p.k. e bënë monitorimin periodik të emisioneve që krijohen gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2, veçanërisht të pluhurit nga proceset e thërrmimit, sitjes, transportimit dhe deponimit të materialit. Rezultatet e monitorimit evidentohen dhe do t'u raportohen institucioneve kompetente.
4.7.	Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit	Kompania "Enisi" Sh.p.k. realizonë monitorimin periodik të cilësisë së ajrit në zonën e impiantit, veçanërisht në pikat ku krijohet pluhur gjatë thërrmimit, sitjes, transportimit dhe deponimit të materialit.

		Monitorimi i cilësisë së ajrit do të kryhet nga kompani e licencuar për matjen e emisioneve në ajër.
4.8.	Raportimet	Kompania "Enisi" Sh.p.k. mbanë evidencë për rezultatet e monitorimit të emisioneve dhe cilësisë së ajrit. Raportet e matjeve, të realizuara nga kompani e licencuar, u dorëzohen institucioneve kompetente sipas kërkesave ligjore dhe kushteve të lejes mjedisore.
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Ndikimet në ajër gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit për përpunim, thërrmim dhe sperimin e shkëmbinjve gëlqeror lidhen kryesisht me pluhurin dhe emisionet e gazrave. Masat për kontrollin e këtyre ndikimeve përfshijnë: Përdorimi i pajisjeve të posaçme për kontrollin e pluhurit, siç janë filtrat e pluhurit dhe aspiratorët për të mbledhur grimcat e ngurta që shkaktohen gjatë nxjerrjes dhe përpunimit të materialeve. Përdorimi i rrugëve të optimizuara për transportin e materialeve dhe përdorimi i mjeteve me emisione të ulëta. Krijimi i barrierave natyrore dhe mbjellja e bimëve për të thithur pluhurin dhe përmirësuar cilësinë e ajrit. Edukimi i punonjësve për përdorimin e metodave ekologjikisht të qëndrueshme dhe sigurohen që ata të jenë të vetëdijshëm për teknikat e ndihmës për kontrollin e ndotjes. Sigurimi që të gjitha makineritë dhe pajisjet të jenë të mirëmbajtura dhe të kalibruara për të ulur emetimet e gazrave të dëmshëm. Krijimi i një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm për cilësinë e ajrit në dhe përreth impiantit për të vlerësuar ndikimet dhe për të ndërmarrë veprime të menjëhershme korrigjuese në rast të tejkalimit të kufijve të lejuar. Impianti përdorë spërkatje gjatë punës ne gurëthyes prandaj nuk ka shumë sasi të ndotjes në ajër
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2 të kompanisë "Enisi" Sh.p.k., ndikimet në ndryshimet klimatike lidhen kryesisht me emisionet nga kamionët, makineritë e punës dhe konsumin e energjisë elektrike. Për zvogëlimin e këtyre ndikimeve përdoren makineri dhe automjete me standarde të përshtatshme të emetimeve, ku bëhet

		mirëmbajtja e rregullt e tyre, do të shmanget puna e panevojshme e motorëve dhe do të organizohet transporti në mënyrë efikase.

5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Kompania "Enisi" Sh.p.k. përdor ujin nga pusi nëntokësor për nevoja të punëtoreve, për spërkatjen e materialit gjatë thërrmimit dhe separimit, lagien e rrugëve të brendshme dhe sipërfaqeve manipuluese për zvogëlimin e pluhurit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujerave sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Nga procesi teknologjik i gurthyesit me separacion nuk krijohen dhe nuk shkarkohen ujëra teknologjike. Ujërat e vetme që krijohen janë ujërat sanitare nga nevojat higjienike të punëtorëve. Këto ujëra shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të fshatit. Shkarkime të tjera të ujërave, përfshirë shkarkimin në ujëra sipërfaqësore, nuk ka.
5.3.	Ndikimet në ujë	Ndotja e ujit është një tjetër ndikim i rëndësishëm që ndodhin gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit për përpunim thërrmim dhe seperim të shkëmbinjve gëlqeror. Gjatë ndërtimit, përdorimi i ujit për proceset e pastrimit dhe larjes mund të shkaktojë derdhje të mbetjeve të materialeve të ndotura, si pluhur dhe kimikate të tjera, që mund të arrijnë në lumenjtë dhe burimet ujore të zonës. Po ashtu, menaxhimi i ujërave të përdorura për operacione industriale është i rëndësishëm për të parandaluar ndotjen e ujit. Në fazën e operimit, impianti mund të përdorë sasi të konsiderueshme uji për spërkatjen e pluhurit gjatë punës në gurëthyes dhe nëse ky ujë nuk trajtohet siç duhet, ai mund të shkaktojë ndotje të ujërave.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Emisionet e ujërave të ndotura nga impianti i kompanisë "Enisi" Sh.p.k. pritet të jenë të kufizuara dhe lidhen kryesisht me ujërat atmosferike, pastrimin e makinerive, lagien e sipërfaqeve manipuluese dhe ujërat sanitare të stafit. Treguesit kryesorë janë lëndët e ngurta pezull, sedimentet, turbullira, pH-ja dhe prania e mundshme e vajrave apo derivateve në rast të rrjedhjeve aksidentale.
5.5	Trajtimi i ujërave tëndotura	Ujërat që krijohen gjatë funksionimit të impiantit të kompanisë "Enisi" Sh.p.k., kryesisht nga reshjet atmosferike, pastrimi i makinerive dhe sipërfaqet manipuluese, nuk mblidhen lihen te lira ne

		menyre natyrore te rrjedhin. Kompania ne fjale nuk bene trajtimin e ujerave te ndotura, pasi që nuk kemi ujera teknologjike dhe kemi vetem ujera te ndotura sanitare të cilat menaxhohen përmes sistemit përkatës sanitar të fshatit. Nuk lejohet shkarkimi i ujërave të patrajtuara në tokë, ujëra sipërfaqësore apo nëntokësore.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Kompania "Enisi" Sh.p.k. nuk bene kontrollin dhe matjet e ujerave.
5.7.	Raportimi	Kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxheri i kompanisë, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë brenda dhe jashtë saje.
5.8.	Leje Ujore për shfrytëzim të ujit	Nuk është e Nevojshme
5.9.	Leje Ujore për shkarkimin e ujërave	Nuk është e Nevojshme
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Ndikimet në ujë gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe sperimin e shkëmbinjëve gëlqeror janë të lidhura kryesisht me përdorimin e ujit për spërkatjen e pluhurit dhe menaxhimin e mundshëm të ndotjes. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë përfshijnë: Uji përdoret për të kontrolluar shpërndarjen e pluhurit gjatë thërrmimit dhe përpunimit të shkëmbinjëve gëlqeror. Përdorimi i ujit për këtë qëllim minimizon ndotjen e ajrit dhe ndihmon në ruajtjen e cilësisë së ajrit pa krijuar konsum të tepruar të ujit. Sigurimi i përdorimit të ujit në mënyrë efikase dhe minimale, për të shmangur shterimin e burimeve ujore. Krijimi i sistemeve për mbledhjen dhe trajtimin e ujit të ndotur, si p.sh. nga kullimi i pluhurit ose mbetjet e tjera të procesit, për të parandaluar ndotjen e trupave ujore të afërt. Monitorimi i cilësisë së ujit në zonën përreth impiantit për të parandaluar ndotjen e mundshme të burimeve ujore që mund të ndodhin nga aktivitete të tjera industriale ose proceset e përpunimit të shkëmbinjve gëlqeror.

6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2 të kompanisë "Enisi" Sh.p.k., burimet kryesore të zhurmës janë thërrmuesit primarë, sekondarë dhe terciarë, sitat vibruese, mullinjtë, shiritat transportues, ngarkuesit dhe kamionët transportues. Zhurma krijohet gjithashtu gjatë ngarkimit, shkarkimit dhe lëvizjes së materialit brenda impiantit. Ndikimi është kryesisht lokal dhe lidhet me orarin e punës dhe funksionimin e pajisjeve teknologjike.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Kompania "Enisi" Sh.p.k. ka kryer matje periodike të nivelit të zhurmës gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2, veçanërisht pranë thërrmuesve, sitave vibruese, mullinjve, shiritave transportues dhe në kufijtë e parcelës. Matjet janë realizuar në dB(A) dhe rezultatet do të krahasohen me vlerat e lejuara sipas legjislacionit në fuqi. Në rast të tejkalimit të niveleve të lejuara, do të ndërmerren masa si mirëmbajtja e pajisjeve, kufizimi i punës së makinerive më të zhurmshme dhe përdorimi i pajisjeve mbrojtëse për punëtorët.
6.3.	Raportimet	Kompania "Enisi" Sh.p.k. ka mbajtur evidencë për matjet dhe kontrollin e nivelit të zhurmës gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2. Në rast se kërkohet nga institucionet kompetente ose evidentohen tejkalime të vlerave të lejuara, rezultatet e matjeve dhe masat e ndërmarra do të përfshihen në raportet mjedisore përkatëse.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Gjatë ndërtimit dhe operimit të Linjës1 dhe 2 të kompanisë "Enisi" Sh.p.k., ndikimet në tokë mund të paraqiten nga mbetjet ndërtimore, depozitimi i materialit, pluhuri dhe mbetjet e ngurta që krijohen gjatë thërrmimit dhe separimit të shkëmbinjve gëlqerorë. Rrezik për ndotjen e tokës mund të paraqesin edhe rrjedhjet aksidentale të vajrave, karburanteve dhe lubrifikantëve nga makineritë dhe automjetet. Nëse materialet dhe mbeturinat menaxhohen në mënyrë të kontrolluar dhe pajisjet mirëmbahen rregullisht, ndikimi në tokë vlerësohet lokal dhe i kufizuar.

7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Ndikimet në tokë gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit për përpunim, thërrmimi dhe seperimin e shkëmbinjëve gëlqeror janë kryesisht të lidhura me shqetësimet që lidhen me deponimin e mbetjeve, shkatërrimin e peizazhit. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë përfshijnë: Zgjedhja e vendeve të sigurta dhe të kontrolluara për depozitimin e materialeve të mbetura nga thërrmimi dhe përpunimi i shkëmbinjve gëlqeror, në mënyrë që të shmanget ndotja e tokës dhe kontaminimi i ujërave nëntokësore. Mbetjet e përpunuara duhet të trajtohen në përputhje me standardet mjedisore dhe mund të riciklohen ose shpërndahen në mënyrë të sigurt. Implementimi i sistemeve për mbledhjen e pluhurit dhe mbetjeve të tjera për të parandaluar shpërndarjen e tyre në mjedis dhe ndotjen e tokës. Mbjellja e bimëve dhe grumbullimi i shkurreve në zonat e prekura për të ndihmuar në riparimin e ekosistemeve dhe për të ruajtur integritetin e tokës. Mbështjellja e materialeve dhe mbetjeve për të siguruar që ato nuk shpërndahen në mjedis dhe nuk ndikojnë në cilësinë e tokës. Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së tokës për të identifikuar ndotjet dhe për të ndërmarrë masa korrigjuese nëse është e nevojshme.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Pas përfundimit të aktivitetit të Linjës1 dhe 2, kompania “Enisi” Sh.p.k. është bërë largi i pajisjeve, makinerive, mbetjeve dhe materialeve të mbetura nga zona e impiantit. Sipërfaqet e ndotura jane pastruar, ndërsa terreni është rrafshuar dhe stabilizuar. Zonat e prekura jane rehabilituar përmes rikthimit të shtresës së tokës, mbjelljes së vegjetacionit vendor dhe krijimit të sipërfaqeve të gjelbra, me qëllim rikthimin gradual të peizazhit dhe kushteve natyrore të lokacionit.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

<table>
<tr><td>8.1.</td><td>Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave</td><td>Gjatë funksionimit të Linjës 1 dhe 2 të kompanisë “Enisi” Sh.p.k. krijohen kryesisht mbeturina të përziera komunale nga aktivitetet e përditshme të punëtorëve, si mbetje ushqimore, ambalazhe dhe materiale të tjera të ngjashme.
Mbeturinat sipas katalogut shtetëror
<table>
<tr><th>Numri sipas katalogut shtetëror te mbeturinave</th><th>Emri i Mbeturinës</th><th>Shkalla e Rrezikshmë risë</th><th>Lloji i planifikuar për Deponim te mbeturinave</th></tr>
<tr><td>20 03 01</td><td>Mbeturina të përziera komunale</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina</td></tr>
</table>
Mbeturinat komunale grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm dhe do t’i dorëzohen operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në Komunën e Suharekës. Materiali steril i ndarë gjatë procesit teknologjik, varësisht nga cilësia, mund të ripërdoret si material mbushës dhe nuk do të trajtohet si mbeturinë kur përdoret përsëri. Mbeturinat e tjera eventuale janë klasifikuar dhe menaxhohen sipas legjislacionit në fuqi.</td></tr>
<tr><td>8.2.</td><td>Përshkrimi i Magazinimit apo deponimit te mbeturinave</td><td>Mbeturinat e përziera komunale që krijohen nga punëtorët grumbullohen përkohësisht në kontejnerë të përshtatshëm, të mbyllur dhe të vendosur në një hapësirë të caktuar brenda zonës së impiantit.
Kontejnerët mbahen në sipërfaqe të rregulluar, larg kanaleve të ujërave dhe zonave ku mund të shkaktohet shpërndarja e mbeturinave nga era ose reshjet. Zbrazja e tyre bëhet rregullisht nga operatori i licencuar për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Suharekës.
Mbeturinat e tjera eventuale ndahen sipas llojit, ruhen në hapësira të veçanta dhe nuk përzihen me mbeturinat komunale.</td></tr>
<tr><td>8.3.</td><td>Përshkrimi për trajtim, përpunimdhe riciklimi të mbeturinave</td><td>Mbeturinat komunale grumbullohen në kontejnerë dhe dorëzohen operatorëve të licencuar. Mbetjet minerale të përshtatshme ripërdoren në proces ose si material mbushës, ndërsa mbeturinat e tjera trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.</td></tr>
<tr><td>8.4.</td><td>Dërgimi për trajtim dhe riciklim te operatori tjetër</td><td>Mbeturinat do t’i dorëzohen tek operatori i licencuar për grumbullim, transport, trajtim ose riciklim, në bazë të kontratës</td></tr>
</table>

	– kontrate me kompaninë me leje përkatëse	përkatëse. Kompania mbanë evidencë për sasitë dhe llojet e mbeturinave të dorëzuara.
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania "Enisi" Sh.p.k. zbaton planin për ndarjen, grumbullimin, magazinimin e përkohshëm dhe dorëzimin e mbeturinave te operatorët e licencuar. Mbahen evidenca për llojin, sasinë, origjinën dhe mënyrën e trajtimit të mbeturinave. Mbeturinat komunale vendosen në kontejnerë, ndërsa mbetjet minerale të përshtatshme ripërdoren. Ndalohet hedhja ose djegia e mbeturinave brenda lokacionit.
8.6.	Raportimi	Kompania "Enisi" Sh.p.k. mbanë evidencë për llojin, kodin, sasinë, mënyrën e magazinimit dhe dorëzimin e mbeturinave te operatorët e licencuar. Raportet do t'u dorëzohen institucioneve kompetente sipas kërkesave ligjore dhe kushteve të lejes mjedisore.
9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Rreziqet kryesore lidhen me lëndimet e punëtorëve, lëvizjen e makinerive, rrjedhjet e vajrave, defektet elektrike dhe zjarrin. Në rast aksidenti, puna ndërpritet, zona izolohet, jepet ndihma e parë dhe përdoren pajisjet përkatëse për intervenim. Kur rasti nuk mund të menaxhohet nga stafi, njoftohen zjarrfikësit, policia, emergjenca mjekësore dhe institucionet kompetente. Kompania ka trajnuar punëtorët dhe do të mbajë evidencë për çdo incident.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Në procesin teknologjik nuk parashihet përdorimi i substancave të rrezikshme kimike. Rreziku mund të lidhet vetëm me vajrat, lubrifikantët dhe lëndët djegëse të makinerive.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve, kompania ka siguruar mirëmbajtjen e rregullt të makinerive, kontrollin e instalimeve elektrike, trajnimin e punëtorëve dhe përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse. Në rast incidenti, puna ndërpritet menjëherë, zona izolohet dhe përdoren pajisjet për fikjen e zjarrit, materialet absorbuese dhe mjetet

		e ndihmës së parë. Çdo aksident evidentohet dhe do të raportohen masat e ndërmarra.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania "Enisi" Sh.p.k., e cila ushtron veprimtarinë e përpunimit, thërrmimit dhe separimit të shkëmbinjve gëlqerorë – Linja 1 dhe 2, në parcelën nr. 00984-2, Zona Kadastrale Studençan, Komuna e Suharekës, mban raport mbi gjendjen e sigurisë. Raporti përfshinë kontrollet e makinerive dhe instalimeve elektrike, pajisjet për mbrojtje nga zjarri, trajnimet e punëtorëve dhe incidentet eventuale.
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Në gurthyesin me separacion zbatohen masa për parandalimin dhe menaxhimin e zjarrit. Pajisjet elektrike dhe makineritë kontrollohen dhe mirëmbahen rregullisht, ndërsa materialet e ndezshme, karburantet dhe vajrat ruhen në vende të sigurta, larg burimeve të nxehtësisë. Në lokacion janë të vendosura aparate zjarrfikëse pranë makinerive, panelit elektrik, depos së karburanteve dhe objekteve ndihmëse. Rrugët e brendshme dhe qasja për automjetet e zjarrfikësve mbahen gjithmonë të lira. Punëtorët trajnohen për përdorimin e pajisjeve zjarrfikëse, ndërprerjen e energjisë elektrike dhe evakuimin e sigurt. Në rast zjarri, puna ndërpritet menjëherë, njoftohet Shërbimi i Zjarrfikësve në numrin 112 dhe personat largohen drejt zonës së sigurt. Aparatet zjarrfikëse kontrollohen periodikisht nga kompania e licencuar.

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nuk ka ndërprerja momentale të punës.
10.2.	Ndërprerja e punës	Ndërprerja e punës nuk bëhet.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHENDETIN E NJERIUT

Gjatë operimit të impiantit të kompanisë "Enisi" Sh.p.k., e cila ushtron veprimtarinë e përpunimit, thërrmimit dhe separimit të shkëmbinjve gëlqerorë – Linja 1 dhe 2, në parcelën nr. 00984-2, Zona Kadastrale Studençan, Komuna e Suharekës, ndikimet e mundshme në shëndetin e njeriut lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën, gazrat nga automjetet dhe rrezikun nga përdorimi i makinerive të rënda.

Ekspozimi i zgjatur ndaj pluhurit dhe zhurmës mund të shkaktojë shqetësime në sistemin e frymëmarrjes, lodhje, stres dhe dëmtim të dëgjimit. Megjithatë, me zbatimin e masave për spërkatjen e sipërfaqeve, mirëmbajtjen e pajisjeve, kufizimin e shpejtësisë së automjeteve dhe përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse, ndikimet mbeten të vogla dhe të kontrollueshme.

Deri më tani nuk është evidentuar ndonjë ndikim negativ në shëndetin e punëtorëve apo të banorëve përreth.

Personi përgjegjës për mjedis
Emri mbiemri
Aldi Jashari
Nënshkrimi

_____

Personi përgjegjës i kompanisë
Emri mbiemri
Ramadan Jashari
Nënshkrimi

_____